

TË VEÇANTË



NË MËNYRËN TONË

RËNDËSIA E DEMOKRACISË

RON (11), GENT (10), ADEA (10), ERËMIRA (10), LEONARD (10), ERA (10), DEA (11), ERIS (10),
LEART (10), LORIS (10)



Demokracia, ky emër kaq i bukur e me vlerë kaq të madhe

Ne si klasë kemi dëshirë t'iu ndihmojmë të tjerëve. Mendojmë se solidarizimi është mënyra më e mirë për të jetuar në paqe me njëri-tjetrin. Prandaj, edhe nuk hezitojmë të solidarizohemi me të gjithë. Ja një rast nga jeta jonë. Nxënësit e klasës sonë, së



bashku me nxënësit e klasave të tjera, kemi vendosur t'iu ndihmojmë fëmijëve në „SOS Fshatrat e Fëmijëve“. Ne kemi shitur ushqimet që i kemi përgatitur në shtëpitë tona dhe të hollat e mbledhura ua kemi dërguar në këtë vend të dashur. Kjo që ne kemi bërë quhet solidarizim. E ky është vetëm një nga elementet e shumta të demokracisë.

Elementet e tjera janë: paqja, toleranca, respekti, barazia, liria, etj. Të gjitha këto elemente janë jashtëzakonisht të rëndësishme për të gjithë ne. Mirëpo, edhe

neve na takon t'i respektojmë këto elemente dhe t'i përdorim kudo që jemi, në shtëpi, në rrugë, në shkollë, etj. Dëshirojmë që shumë shkurt t'iu tregojmë një historik për formën më të mirë të qeverisjes, demokracinë. Demokracia në vitin 507 p.e.s. u paraqit për herë të parë në kryeqytetin e Greqisë, Athinën. Kjo formë e qeverisjes ndryshon shumë nga ajo që është sot. Kjo për shkak se barazia si element i demokracisë nuk ekzistonte, meqë vetëm burrat e pasur ishin pjesë e vendimmarrjes. Por, me kalimin e viteve gjithçka ndryshoi për të mirë. Sot e kemi demokracinë, e cila na dhuron gjithçka që na duhet për të pasur jetë të lumtur.


E tëra që duhet të bëjmë është të jetojmë me të, ta ruajmë, ta duam dhe ta zhvillojmë. Demokracia kërkon që të gjithë ne qytetarët të jemi të bashkuar. Fundja, jemi ne ata të cilët udhëheqim.



Ne demokratët të cilët e kemi shkruar këtë artikull

SOVRANITETIN E USHTROJMË ME ANË TË VOTAVE

BURON (10), RËBLINA (10), SHPAT (10), VALËZA (11), VENIS (10), ELDA (10), DREN (10), MELIKA (10), LUM (11), ART (11)



Kur një qytetar vendos të marrë pjesë në procesin zgjedhor, ai/ajo me atë veprim kalon në një nivel tjetër. Ky nivel është më i lartë, e emërohet si qytetari aktiv

Ne jemi të rinjë e kemi plot ëndrra. Ëndrra të cilat mund t'i realizojmë me vullnetin tonë të mirë.

Në vazhdim do të tregojmë një shembull se si ne me anë të kërkesave tona, kemi arritur të zgjedhim diçka. Një ditë, ishim shumë të lodhur, meqenëse kemi pasur shumë detyra të cilat na i ka dhënë mësuesja që t'i kryejmë. Por, si shpërblim, mësuesja vendosi që një orë pas mësimit, punën e mirë që e kemi bërë të na e shpërblej me një aktivitet argëtues. Ne kishim tre alternativa, prej të cilave duhet të zgjedhim vetëm njërën. Ishte loja „Kush është më i shpejti?“, „21“, si dhe „Në mes dy zjarreve“. Ne vendosëm që përmes votave të zgjedhim se cilin aktivitet ta realizojmë. Si përfundim, më shumë vota u mbledhën për aktivitetin

„mes dy zjarreve“.

Kur të rritemi, ne do të bëjmë edhe zgjedhje të tjera. Këto zgjedhje do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së shtetit tonë. Llojet e zgjedhjeve ku ne mund të marrim pjesë nga moshë 18 vjeçare janë zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore.

Zgjedhjet lokale janë zgjedhje, të cilat bëhen brenda një komune, dhe prej tyre zgjedhet kryetari i komunës dhe asamblistët e komunave përkatëse. Ndërsa, zgjedhjet qendrore janë zgjedhje prej të cilave nga votat e qytetarëve zgjedhen deputetët, të cilët punojnë në Kuvendin e Kosovës. Të gjitha këto që i përmendëm më lart, ndodhin për arsye se ne jetojmë në një shtet demokratik.




Votat tona ndikojnë në të ardhmen tonë



Ne zgjedhëm demokracinë

VEPRIMET DHE TË DREJTAT E QYTETARËVE

JON (10), DONART (10), BLERON (10), ANDI (10), TUBA (11), ELTON (10), ERJON (10), DAORSA (10),
AMAR (10), MEDINA (10)



Ne sot biseduam për qytetarinë aktive. Kjo temë për neve ishte shumë e lehtë, sepse edhe ne jemi qytetarë aktiv. Nëse doni të mësoni se çfarë bëjmë ne dhe çfarë mund të bëni ju, lexoni këtë artikull

Fillimisht do të flasim për qytetarët. Ne kemi thënë se qytetarë janë ata persona të cilët jetojnë në fshat apo edhe në qytet. Qytetarët kanë të drejtë të bëjnë gjithçka që ata dëshirojnë, në përputhshmëri me ligjet. Në Kosovë ka rreth 2 milionë banorë. Regjistri civil është një libër në të cilin janë të shënuara të gjitha të dhënat e këtyre qytetarëve.

Gjatë Punëtorisë së sotme, ne mësuam se çfarë është një projektligj. Projektligji është versioni i parë i dokumentit të një ligji, i cili miratohet në Kuvend. Për t'u marrë parasysh një projektligj, ne qytetarët duhet të mbledhim së paku 10.000 nënshkrime. Projektligji më pas miratohet në Kuvend nga deputetët. Ne tentuam ta bëjmë një projektligj që ka të bëjë me: formimin e një

ligji të ri i cili dënon qytetarët të cilët dëmtojnë planetin Tokë. Ne gjithashtu kërkojmë një ligj tjetër, i cili ka të bëjë me punësimin e qytetarëve. Ky projektligj mori 11 nënshkrime nga grupi ynë. Këtij projektligji i kanë mbetur edhe 9.989 nënshkrime, të cilat shpresojmë se do t'i marrë nga qytetarët e tjerë aktiv.

Ne kemi diskutuar edhe për veprimet e qytetarëve aktiv. Qytetarët aktiv kanë të drejtë të ndihmojnë shtetin e tyre. Atë e arrijnë duke bërë punë vullnetare, duke ndihmuar të tjerët, duke mbrojtur ambientin, etj. Qytetarët kanë të drejtë të bëjnë kërkesa të ndryshme, të propozojnë projektligje, të organizojnë protesta paqësore, vetëm nëse nuk janë të pajtimit me vendimet e caktuara shtetërore. Kjo ndodh vetëm në vendet në të cilin ekziston qeverisja më e mirë në botë, e që është demokracia. Këto janë disa fakte për qytetarinë aktive. Ndërsa, në faqen tjetër do të vazhdojmë të flasim edhe pak për këtë temë kaq interesante.



Fytyrat tona të përkushtuara flasin shumë



Ja si duken gazetarët më të vegjël të Kosovës

Tani do të flasim për votën dhe kandidimin. Qytetarët nga mosha 18 vjeçare mund të votojnë. Ata mund edhe të kandidojnë. Vota nuk është një obligim ligjor, por është një përgjegjësi e qytetarëve.

Kurse, tani do të flasim për përgjegjësitë e qytetarëve. Përgjegjësitë e qytetarëve janë: respektimi i ligjeve, respektimi i qytetarëve të tjerë, mbrojtja e ambientit, pagesa e taksave, etj. Në fund, do të flasim për punën vullnetare të fëmijëve.

Duke biseduar për ambientin dhe mbrojtjen e tij, neve

na u kujtua një ngjarje e cila ka ndodhur disa vite më parë. Me datën 22 prill të vitit 2015 me klasën tonë dolëm në oborrin e shkollës sonë që të pastrojmë ambientin. Kjo tregon për mënyrën se si edhe ne si fëmijë aktiv mund të shërbejmë në të mirë të komunitetit tonë. Edhe neve na takon përgjegjësia e vendit tonë, Kosovës. Ne e duam atë, prandaj punojmë për ta zbukuruar edhe më shumë.

Faleminderit për vëmendjen tuaj, më të dashur lexues të kësaj gazete.




Edhe ne kemi të drejtë ta ngrisim zërin për të mirën e shtetit




Këtu jemi ne duke pastruar ambientin e shkollës sonë



Vendi ku ne u ndjemë të vlefshëm dhe të barabartë. Pikërisht siç edhe duhet të ndodh në demokraci



Ne jemi si ngjyrat. Të gjithë të ndryshëm, por të veçantë



E drejta e strehimit, një e drejtë qenësore për të gjithë ne



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pavarësia“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-4
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë